REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 736/20
Datë/Datum. 07.10.20
PRISHTINË · PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

A.nr.736/20

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, neni 4 Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, si dhe nenin 17 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër te protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE "BM Group" SH.P.K. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit AP: 622-20-2058-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 622-20-028-2-1-1, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Prizren, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra më datë: 05 TETOR 2020 mori këtë :

VENDIM

I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE "BM Group" SH.P.K. - Prishtinë, me nr. të protokolli. 736/20, e datës: 30 SHTATOR 2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit:

"Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit AP: 622-20-2058-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 622-20-028-2-1-1, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Prizren.

II. **Mbetet në fuqi pezullimi i vendimit** të Autoritetit Kontraktues – Kuvendi Komunal Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit AP: 622-20-2058-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 622-20-028-2-1-1, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Prizren, pasi që për të njëjtin aktivitet është edhe një ankesë në shqyrtim të rregullt.

III. Ankesa e Operatorit Ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta nuk është proceduar sipas nenit 108/A dhe 109 të LPP-së si dhe nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, operatorit ekonomik ankues sipas nenit 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet tarifa e ankesës.

IV. **Obligohet,** OE ankues që konform nenit 31 pika 6-të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Më datë 30 SHTATOR 2020, Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik ka pranuar ankesën e parashtruar nga ana e OE "BM Group" SH.P.K. - Prishtinë, e cila ankesë protokollohet me nr. të protokollit: 736/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit AP: 622-20-2058-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 622-20-028-2-1-1,

të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Prizren.

Për ankesën e parashtruar si më lart OSHP ka kërkuar prova shtesë nga palët në procedurë dhe AK me datën 01.10.2020, ka ofruar ketë sqarim:

Lidhur me kërkesat për sqarim shtesë lidhur me kërkesën për rishqyrtim të BM grup, po iu njoftojmë se kjo kërkesë është refuzuar si e pabazuar nga ana e Autoritetit kontraktues.

Me që lënda ka qene e pezulluar me datë 14 09. 2020 është bërë ngatërrimi I datave dhe kjo date është marrë si datë e VENDIMIT e jo si date e PEZULLIMIT:

Kjo kërkesë është dashtë të refuzohet siç edhe është bërë, por si e jashtëfatshme e jo si e pabazuar. Iu kërkojmë ndjesë për ngatërrimin e datave por edhe juve iu bëjmë me dije se në ditë kemi edhe nga 5 kërkesa për rishqyrtim kështu që njerëz jemi edhe na ngatërrohen datat.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka analizuar ankesën e parashtruar nga OE "BM Group" SH.P.K. - Prishtinë, me nr. të protokollit: 736/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit AP: 622-20-2058-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 622-20-028-2-1-1, të iniciuar nga AK /Kuvendi Komunal Prizren, dhe bazuar në verifikimin e shkresave të lëndës si dhe në platformën e-prokurimi kjo ankesë rezulton të jetë e pa lejuar nga se ankues i ka humbur afatin ligjor për parashtrim te kërkesës për rishqyrtim në AK.

Autoriteti Kontraktues (AK) "Kuvendi Komunal Prizren" për aktivitetin e prokurimit "Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit AP: 622-20-2058-2-1-1 dhe numër të brendshëm: 622-20-028-2-1-1, me Vendimin e tij dhe me Letrën Standarde e ka njoftuar OE ankues me dt. 09.09.2020.

Kundër Njoftimit të lartcekur Operatori Ekonomik (OE) ankues ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim të Vendimit të AK-së me dt. 16.09.2020, në ditën e 7-të kalendarike.

AK me dt. 21.09.2020, i ka kthyer përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim.

Operatori Ekonomik ka parashtruar ankesë në OSHP më datë 30.09.2020.

Andaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se duke pasur parasysh faktin se AK me

vendimin për anulim të aktivitetit e ka njoftuar OE ankues më dt. 09.09.2020, afati ligjor sipas LPP-së, për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim ka filluar të rrjedhë nga data 10.09.2020, nga ora 08:00 deri në ora 16:00, dhe ka përfunduar me datë 14.09.2020 ora 16:00 (duke pasur parasysh faktin se dita e njoftimit llogaritet dita 0).

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se OE: "BM Group" SH.P.K. - Prishtinë, ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, sepse i njëjti OE ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim te vendimit te AK-së në ditën e shtatë (7) , andaj ankesa e datës 30.09.2020 me numër të protokollit 736/20, nuk mund të shqyrtohet nga OSHP dhe e njëjta hedhet si e pa lejuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 5 i LPP-së specifikon :
Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të dielë ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se neni 9 paragrafi 1 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon: Ankesa pranë OSHP-së, duhet të dorëzohet vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes dhe të dorëzohet brenda dhjetë (10) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues në procedurën paraprake të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të LPP-së.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: "BM Group" SH.P.K. – Prishtinë, e datës 30.09.2020 me numër të Protokollit 736/20, hedhet si e jashtëafatshme sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në OSHP në kundërshtim me nenin 9 të Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi Sekretariatit të OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Kuvendi Komunal Prizren

1x1 OE "BM Group" SH.P.K. - Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së